

VITI XV, NUMRI 9 / SHTATOR 2011

# FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA

## Holiday Rally

POREČ

30.09. - 01.10.2011.





# Ji i LIRË!

**Ç**do vit dallohet nga ngjarjet e rëndësishme që kalojnë, që nga ditët e festave, përvjetorët e deri tek ditëlindjet. Këto janë shumë të rëndësishme, por në këta 33 vitet e fundit unë kalimin e një viti tjetër të sukseshëm e dalloj nga një ngjarje e madhe në të cilin marrim pjesë-nga takimi vjetor Super Rally!

Çfarë evenimenti i mrekullueshëm ishte. Hodhëm në treg disa produkte të reja të shkëlqyera, kremtuam arritjet, dhe sigurisht kaluam një kohë të mrekullueshme. Në saje të përpjekjeve të gjithsecilit, ju u kualifikuat dhe punuat fort për 12 muaj

për të fituar këtë çmim; unë ju ftoj të gjithëve ta bëjmë këtë edhe vitin e ardhshëm. Dhe juve që nuk e arritët, unë ju ftoj të riangazhoheni, dhe përcaktoni objektivat tuaja për kualifikim për takimin Super Rally, motivoni më tej njerzit e rrjetit tuaj të përcaktojnë edhe ata objektivat e tyre...dhe të luftojnë për ti bërë realitet!

Washington D.C është një qytet spektakolar. Shpresoj që ju që morët pjesë në takimin Rally, të keni patur mundësinë të vizitoni shumë nga gjërat e veçanta që ofron ky qytet. Sigurisht për të gjithë amerikanët por edhe për miliona njerëz në mbarë botën, Washington D.C mbetet simbol i lirisë. Nga monumenti i Washingtonit dhe deri tek memorialet e Linkolnit dhe Xhefersonit, të gjitha këto objekte na kujtojnë të gjithë neve sakrificat që kërkon liria. Prandaj ne kemi menduar se lejtmotivi ynë i ri për 2011-12, JI I LIRË, është shumë i përshtatshëm. Shumë njerëz të ndritur kanë folur për lirinë dhe për kuptimin e saj. Më lejoni të citoj disa nga favoritet e mi:

*„Liria e individit nuk mund të ekzistojë pa sigurinë dhe pavarësinë ekonomike. Njerzit që janë pa punë dhe kanë uri janë lënda nga e cila formohen diktaturat.”*

Franklin D. Ruzvelt

*„Çdo njeri ka katër veti: vetëdijen, ndërgjegjen, dëshirën e pavarësisë dhe imagjinatën krijuese. Këto na japin lirinë njerëzore më të lartë...Fuqinë për të zgjedhur, për të reaguar dhe për të ndryshuar.”*

Stephen Covey

*„Liria nuk ja vlen ta kesh në qoftë se nuk nënkupton edhe lirinë për të gabuar”*

Mohandas K. Gandhi

*„Të jesh i lirë nuk do të thotë thjesht të flakësh zinxhirët, por të jetosh në një mënyrë që të respektosh dhe zgjerosh lirinë e të tjerëve”*

Nelson Mandela

Produktet e Foreverit dhe plani ynë i veçantë i marketingut na ofrojnë të gjithë neve liri në shumë aspekte të jetës: liri nga shqetsimet financiare; liri të jesh dhe të bësh çfarë të duash; liri nga shumë shqetsime shëndetsore të kohës së sotme. Vërtet kemi fuqinë të zgjedhim të jemi të lirë aq sa duam. Por ne gjithmonë nuk duhet të harrojmë se me lirinë e madhe vjen edhe një përgjegjësi e madhe: përgjegjësia që këtë mundësi të madhe ta ndajmë me të tjerët; përgjegjësinë që këtë biznes ta zhvillojmë në perputhje me politikën që kemi përcaktuar; përgjegjësinë për të ndihmuar edhe ata poshtë nesh të bëhen të sukseshëm, ashtu siç duan të jenë.

Duke filluar vitin e ri të Foreverit, unë shpresoj se të gjithë ne do të afishojmë lejtmotivin tonë JI I LIRË në një vend të dukshëm, në shtëpitë tona, në zyrat tona, në makinat tona, apo ku kalojmë një pjesë të konsiderueshme të kohës. Le të jetë ajo një kujtesë e vazhdueshme për gjithshka ofron Foreveri, dhe se kjo është realisht mundësia më e madhe në botë për të qënë vërtet i LIRË.



# FOREVER GOING GLOBAL

## FOREVER ME PERMASA GLOBALE



**T**akimi Super Rally i vitit 2011 mund të quhet historik për Forever Living Products International. Me parrullë „Going global” Rex Maughan bëri realitet që Forever Living duke parakaluar me ecjen përpara në shkallë botërore si skuadër pararojë e marketingut në rrjet (MLM). Për ndryshimin e një vizioni të tillë me permasa botërore, ishim dëshmitar me sy e veshë në takimin e Washingtonit, që faktikisht ishte me rëndësi vendimtare në konkurimin e udhëheqjes të tregut.

Foreveri është e vetmja firmë e tillë botërore që një pjesë të distributorëve të saj- dhe këtu do të theksoja bëhet fjalë për disa mijra vetë - i fton në një takim të ri botëror Global Rally, me shpenzimet e vetë kompanisë.

Ai që në periudhën e kualifikimit nga Janari në Dhjetor (kualifikimi nis në vitin 2012), duhet të ketë grumbulluar të paktën 1500 CC ose të jetë kualifikuar në programin stimulus Profit Share, automatikisht i sigurohet bileta e avionit për në një nga zonat më ekzotike të botës.

Me habi dhe me mirnjohje shikojmë tek pronarët dhe drejtuesit e Foreverit, që si një hap të ri gjigant, kanë vendosur një objektiv që mund të bëhet ëndërr e prekshme për këdo. Sfidat është e jashtëzakonshme, ajo u drejtohet atyre, që mendojnë seriozisht për të ardhmen e tyre, të ardhmen e familjeve dhe të dashurve të tyre. Atyre që personalisht ishin në Washington, atyre personalisht mund tu them, se e perjetuan, e ndjenë energjinë dhe bëmë betimin për sfidat e reja, sepse atje e kemi vendin edhe për takimin e ardhshëm Global Rally. Programi stimulus në shkallë botërore Profit Share 2.0 është sistem nxitës i Forever Living. Rezultati i fitimit ndahet për grupin e menaxherëve që punojnë në vënde të ndryshme. Praktikisht rezultati yt dhe rezultati i Foreverit në shkallë botërore përcakton madhësinë e çekut të fitimit, këtu nuk ka kufij. Në vitet e ardhshme do të jemi dëshmitarë i surprizave të bukura në sipërmarrjen e Foreverit.

Me qënë se Foreveri funksionon në mbi 150 vende në mbarë botën, praktikisht mund të themi se me familjen e Foreverit është bashkuar një pjesë e madhe e botës. Ne si përfaqësues të Hungarisë dhe të vendeve të rajonit të Ballkanit, si rezultat i punës plot përkushtim i bashkpunëtorëve tanë, në 150 vendet e Foreverit na takoi nderi të zinin vendin e gjashtë. Personalisht, falnderoj të gjithë bashkpunëtorët tanë për përpjekjet e tyre dhe u premtoj, se në vitet që do të vijnë do të bëj gjithshka është e mundur që edhe në të ardhmen të mund të jemi ndërmjet më të mirëve, mbasi tashmë të jesh ndërmjet 10 sipërmarrjeve më të mëdha të botës, është e mundshme vetëm me aftësi të jashtëzakonshme.

U faleminderit sipërmarrësve forever të vendeve të vogla por gjigand nga aktiviteti, për këmbnguljen, zellin dhe durimin e tyre në punë. Këtë rezultat që vendosi në tavolinën e Foreverit në Washington grupi ynë, ndoshta mund ta përsërisin vetëm kapitenët e një skuadre të përbashkët hungarezo- sllavojugore të waterpolos!

Rex Maughan, Gregg Maughan, Aidan O'Hare na ofrojnë ne mundësinë e madhe, që askush nuk na i ka ofruar në këtë Tokë. Aftësohu që ti përgjigjesh kësaj mundësie, të jesh i shëndetshëm, i pasur, i lirë dhe të shijosh çdo sekondë të jetës tënde!

Zgjohu, FLP!  
Përpara FLP!

DR. SÁNDOR MILESZ  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



# WASHINGTON

☆☆☆

## SUPER RALLY 2011

# DC



Tashmë vetë udhëtimi filloi me një nderim të veçantë, mbasi FLP i kishte organizuar në banjën e rezeve të diellit të agimit na mori nga aeroporti Budapestit, nga ku vazhduam rrugën drejt Frankfurtit. Mëngjezin e hëngrëm në sallën e pritjes të rezervuar për udhëtarët e klasit të parë, pastaj pas gjysëm ore nisëm udhëtimin tonë drejt kryeqytetit të SHBA.

Vëndi i zhvillimit të aktivitetit ishte një nga qendrat më të mëdha të kongreseve, Hotel Prince George dhe Exhibit Hall. Me Andrejan realizuam nivelin e zafir menaxherit, kështu që na u dha titulli që ditën e parë. Për hotel na çuan në një dhomë të mrekullueshme, nga ku dukej gjithë aktiviteti. Hoteli ishte aq i madh, ku në mes funksiononte me muzikë një shatërvan, pranë tij një shesh shetitje, vende pushimi, dyqane, restorante dhe vende argëtimi, ku shijuam luajtjen në pjano të këngëve të preferuara nga të gjithë.





Ditën e parë u nisëm me bicikletë për tu njohur me qytetin e Washingtonit dhe mund të them se vizituam pjesën më të madhe të kryeqytetit (Shtëpinë e Bardhë, Bashkinë, muzeumet...).

Të dyve na befasoi pastërtia dhe qetësia e qytetit. Falë FLP shkuam edhe në shumë qytete të tjera të SHBA, ku nga pikpamja e ndjenjës të sigurisë ky vend është i shkëlqyer. Më pas lundruam me anije, duke shetitur përgjatë lumit Potomac, ku na u krijua ndjenja sikur ishim në det. Hotelet dhe godina të tjera që shkëlqenin nga ndriçimi na dhanë pamjet e netëve të mrekullueshme dhe të paharruara.

Ditën e dytë u regjistruam dhe morëm pakot e mirëseardhjes: një çantë udhëtimi, brënda xhel, pastë dhëmbësh, Lips, Moisturizing Lotion, Bath Gelee, 4 ujë Sirona, 4 çokollata Fast Break, 2 bluza, 2 blloqe shënimesh, dhe besoni apo jo nga Dr Sándor Mílesz morëm si pare xhepi nga 500 dollar dhe krahas këtyre, për çdo njeri edhe nga një zarf me 90 dollar për shpenzime të ndryshme. Kur kujtoj ndërmarrje të tjera, atëhere mendoni, jam në ëndërr apo mburrem. Në të vërtetë është vështirë të besohet, që ndërkohë që ke marrë shpërblimin e programit të veturës FLP, shpërblimin Profit Share, udhëtimin falas, të mos të harrojnë që në emër të Foreverit, të ardhurit edhe ti rehatojnë e kënaqin plotësisht.





Mundësitë janë të hapura për pjesmarrje në trainimin FLP Biz. Nga pikpamja e të ardhmes globale të kësaj kompanie, programi Biz dhe blerja me internet që mund të bëhet që nga dhoma e ndenjtes, janë një mundësi e jashtzakonshme. Nga zemërgjerësia e kompanisë duke ju referuar atyre që bien në fatkeqsi, është krijuar fondacioni Forever Giving. Të mos harrojmë se sipas ligjeve të universit, forca e natyrës ta shpërblen shumëfish ndihmën e dhënë.

Të premtën, pas mëngjezit morëm kufjet dhe filloi takimi fantastik, dita e parë zyrtare e Rally-it ku falnderimi festiv i **Rex** dhe prezantimi magjepsës të mbeten për jetë në kujtesë. Pika e parë ishte titullimi festiv i zafir menaxherëve. **Dr Sándor Miliesz** ishte kujdesur që të ishim në kohë në skenë, duke na kaluar para turmës, në sytë e tij shikoja krenarinë. Nga Sllovenia, përveç nesh nuk kish pjesmarrës të tjerë dhe nuk e kishim llogaritur të kishim një duartrokitje kaq të zjarrtë, dhe këta ishin përfaqsesit e rajonit tonë. Falnderime të sinqerta të gjithëve!

E njoh ligjin e veprim-kundërveprimit dhe e njeh edhe **Attila Gidófalvi**, i cili i pari na priste në fund të shkallëve për të na uruar me sinqeritetin e tij. U faleminderit edhe të tjerëve, të gjithë atyre, që erdhën atje. Jo më kot dikush është njeri i





madh, **Veronika Lomjanski** na surprizoi me dhuratat e saj. Ditën e mbyllëm me një natë argëtuese të organizuar nga **Dr Sándor Miliesz**.

Dita e dytë e Rally-it ishte dita e surprizave të pafund. Në këtë ditë morën titujt e menaxherit diamant **Attila e Kati Gidófalvi** dhe **Miklós Berkics**. Ata janë modeli i sponsorit të persosur. Attila dhe Kati na vënë para sfidave të reja, si ta aplikojmë forcën e besimit në atë që bëjmë. Pas kësaj vijon prezantimi i produkteve të reja, për të cilat pa dyshim do të frymëzohemi, dhe një vrull të ri do ti japin biznesit tonë. Shampo e balsam flokësh të reja, një Kids i ri përbërësit dhe shijen e të cilit do ta adhurojmë, paleta të reja Sonya dhe Imublend, një produkte i përgatitur sipas një teknologjie me patentë të veçantë për forcimin e imunitetit. Mirënjohje e plotë i takon grupit shkencor për këtë produkt të cilësisë së lartë. E di se do ta adhuronin edhe koleksionin e ri Aloe Fleur de Jouvence. Dhe surprizat nuk marrin fund: sipas xhiros, shpallen 10 vendet më të mira në botë. Lëvdata i takojnë rajonit tonë që në mbi 150 vende të botës ku vepron FLP, zuri vendin e gjashtë, ku sipas raportit me numurin e popullsisë është një rezultat jashtëzakonisht i lartë. E di se do të zhvillohemi që të mund të bëhemi edhe më të mirë, besoj tek distributorët dhe ju lutem atyre, çojini këto produkte të





mrekullueshme dhe lajmin e kësaj mundësie të veçantë biznesi të Foreverit në çdo familje! Miku dhe lektori që pasoi ishte shkencëtari i çmimit Nobel, **dr. Louis Ignarro**, studjuesi i dëgjuar i veprimit nitrogjen-monoksid që aktivizohet nga aminoacidi L-arginine. Falnderoi Foreverin për hedhjen në treg të produktit me cilësinë më të lartë Argi+. Njeriu habitet sa shkencëtarë, mjekë dhe specialistë të tjerë gjenden në radhët e distributorëve të produkteve Forever! Në vesh më tingëllojnë fjalët e dr Marija Ratkovic nga Serbia, kur më tha: „Tomo, a e di se nuk e imagjinojmë se çfarë produktesh të veçanta janë? Dhe ajo që është më e rëndësishmja, këto mund tia rekomandosh kujtdo, sepse nuk kanë kurrfarë efekti të dëmshëm, kur njëkohsisht mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë të jetës të njerzve.” Pas kësaj në skenë u ngjit **Gregg Maughan** i cili prezantoi parrullën e re „Forever Going Global”, që do të thotë se në biznesin Forever nuk ka kufij. Sipërmarrjen tonë mund ta ndërtojmë në gjithë botën, dhe në gjithë botën mund të udhëtojmë, mbasi Global Rally nga viti në vit do të zhvillohet në vënde të ndryshme të botës. Në Rally mund të marrin pjesë edhe ata që kanë plotësuar kushtet e reja të Profit Sharing! Rregullat e reja të Profit Sharing nënkuptojnë përhapjen e biznesit Forever në shkallë botërore dhe sigurojnë mundësi më të mëdha fitimi.

Në fund u shpall se qyteti i Phoenix do të presë pjesëmarrësit e World Rally-it të ardhshëm. Me kënaqsi njoftoj se me Andrej kemi realizuar 1500 pikët, prandaj falnderoj gjithë bashkpunëtorët dhe menaxherët për çka realizuam në gjashtëmuorin e parë të këtij viti. Kam bindjen se edhe gjashtëmuorin e dytë do ta mbyllim me rezultate për tu patur zili, dhe e ndjej se po i afrohem një rekordit të ri vjetor, që dëshmon se me dashurinë e Foreverit kemi prekur shumë njerëz, të cilët me përvojën e mirë që kanë siguruar për këto produkte do ti japin një vrull edhe më madh. Faleminderit zyrës të FLP Slloveni, faleminderit zyrës të FLP Buadapest, faleminderit ty Forever!





Të jeni mirënjohës për shëndetin që keni, sepse është më lehtë ta ruash se sa ta rivendosësh. Me shijet dhe mendimet tuaja provoni shijen e suksesit, veproni sikur ta keni arritur dhe do ta shikoni se mirësia gjithmonë kthehet atje nga ku është nisur.

Tomislav & Andreja Brumec  
zafir menaxherë



FOREVER   
GOING GLOBAL



*Kohët e fundit kemi marrë letra nga shumë shikues, lidhur me funksionimin e programit televiziv FLP TV TUBE. Shumica e çështjeve kanë të bëjnë me atë që nuk fillon menjëherë programi i përzgjedhur, se mungon figura apo zëri. Shkak i kësaj mund të jenë programet e shumëllojshme, jo gjithmonë zgjidhet tipi i skedarit të dëshiruar me të cilin punon televizioni i FLP. Për këtë propozoj që nga Interneti të shkarkoni falas programin kompjuterik Firefox, por kjo faqe më mirë punon versionin më të ri të Windows Explorer. Grupi i FLP TV, edhe më tej ju uron shikim të këndshëm!*

Sándor Berkes  
FLP TV



# DITA E DYTË E SHËNDETIT NË FOREVER

NË FAMILJEN FOREVER ÇDO DITË ËSHTË DITË SHËNDETI! DO TË DONIM QË NË SA MË SHUMË FAMILJE NË 365 DITË TË VITIT TË FLISNIN PËR SHËNDETIN. PËRATË SHËNDET QË ORGANIZATA BOTËRORE E SHËNDETSISË (OBSh) EPËRCAKTON SI MË POSHTË: "SHËNDETI ËSHTË GJËNDJA E E MIRË TRUPORE, SHPIRTËRORE DHE SOCIALE, DHE JO VETËM MUNGESA E SËMUNDJEVE APO QËNIA HANDIKAPAT" PRA EDHE SOT KJO ËSHTË EVLEFSHME, NJË OBJEKTIV QË DUHET ARRITUR!

**N**ë rastin e 2-të të Ditës së Shëndetit, nga drejtuesit tanë, bashkë me bashkshortin tim morëm një detyrë të nderuar, të mbështetur edhe nga Aranka Vágási; mundëm të ishim drejtues të programit sportiv. Aranka Vágási, me të drejtë çështjen e çadrës të caktuar për sportin e kishte shumë për zemër, mbasi ndërmjet lektorëve të sportit, ajo ka vlerësimin më të lartë dhe në çadrën e sportit ajo ishte lektorja e rangut më të lartë, si Diamant-Zafir menaxhere. Vërtet një personalitet i veçantë në botën e Foreverit!

Cili ishte objektivi i programit të çadrës sportive të Foreverit? Për të treguar atë qënë jetën sportive, çfarë ndikimi të mirë kanë ë personalitetin e njeriut, në moralin e punës dhe në mënyrën e të menduarit, dhe sigurisht jo në radhë të fundit për shëndetin, veçanrisht në se i përdor përditë produktet e Foreverit. Dhe sigurisht të mos harrojmë asë mirëqënie sociale. Dhe këtë mund ta sigurosh nëpërmjet biznesit të Foreverit, pra të gjitha në një vend! Gjatë programit u prezantuan ata drejtues të shkëlqyer, të cilë si me të kaluarën e tyre sportive ashtu edhe me rezultatet e arritura në jetën e biznesit në Forever, me meritë janë model për njerzit e sotëm. Treguan se si sfidat e jetës së tyre sportive i kanë mësuar ata që gjithmonë dhe në çdo rrethanë kanë vlerësuar punën që me modestinë dhe përkushtimin e duhur të kryejnë punët e perditshme, të durojnë dhimbjet, sfidat dhe ndeshjet që vijnë nga përpjekjet më të mëdha.

Treguan me jetën e tyre, përmes historive të tyre, se fitorja gjithmonë është rezultat i punës këmbëngulëse dhe kjo nuk është ndryshe as në biznes. Shëmbulli i drejtuesve të sukseshëm në jetën sportive dhe në biznes, u dha shumë forcë e besim gjithë atyre, që i dëgjuan ata.

Ju urojmë nga zemra një jetë të shëndetshme, sportive e të gjallë:

**Éva Keszi Szépné, ish volejbolliste e NB II dhe Mihály Szép, disa herë volejbollist i kampiones hungareze – soaring menaxherë**





Dita e shëndetit. Atje ishte edhe ti?. Atëhere nuk kam pse të flas për turmat që gumëzhinin para pavilioneve që pergatiteshin për jetën e shëndetshme. Nuk do duhej të të flisja për leksionet argëtuese dhe njëkohsisht mësimdhënëse, për kënaqitë e jetës dhe për forcën mahnitëse të FLP. E more seriozisht, dhe në këtë ditë u takove, bisedove dhe pyete për shëndetin tënd mjekët, ndërsa për jetën e biznesit të Foreverit takove drejtues që me fakte të garantuan për mundësitë fantastike të FLP që shtohen çdo ditë. Gjithë ditën ndjeve shtërngimin e duarve, përfaqifimet, buzqeshjet miqësore, përkujdesjen e dashur. Takohemi prap në të ardhmen!

**Laci dhe Mariann Gecző – senior menaxherë**

Këtu u befasova, për atë që në të vërtetë e dija edhe deri tani, vetëm se nuk guxoja ti përvishesha, që pa lëvizse sistematike trupore nuk ka as gjëndje të mirë shpirtërore, pa të cilën nuk ka as ndjenjë të vërtetë suksesi. Ka rëndësi të ushqehemi si duhet, por krahas kësaj po kaq e rëndësishme është edhe lëvizja. Bukur i shkuan këtij aktiviteti edhe njëzet minutat e ushtrimeve aerobike që bëri në skenë Eszter Nagy.

**Marianna Farkasné menaxhere**



Dita e shëndetit e vitit 2011 për mua ishte një ndihmë e madhe për të rifilluar. Shikova në të tri podiumet e leksioneve, dhe pashë se kudo zhvilloheshin programe të nivelit më të lartë. Megjithatë mua më tërhoqën më shume leksionet e sportistave. Mundëm të takoheshim me sportistë të tillë të cilët nëpërmjet punës së tyre na treguan shëmbullin e ndërtimit të biznesit. Mua askush nuk më ka ngritur në orënkatër të mëngjezit që ti bie rrotull BudaOrsit dhe nuk më duhet të ngre çdo ditë tonelata. Fakti është se mua në rrethana esencialisht më të lehta, esencialisht me një punë më të lehtë, do ta bëja për më shumë para vetëm atëhere do të jetë e dukshme, nqse pranë saj është ky kontrast verbues.

**Isván Skáfár menaxher**

Aktiviteti ishte i një niveli shumë të lartë, me informacione shumë të dobishme, me programe të lezetshme. Gjithkush mund të gjente atë që i interesonte. Kishte nga ata që donin vetë një kontroll mjekësor të pergjithshëm falas, por ndërkohë dëgjuan edhe disa leksione. U pa se lektorët dhanë njohuritë e tyre më të mira, dhe dhanë hapur përvojën dhe eksperiencën e tyre. Pamë se vërtet donin të ndihmonin dëgjuesit për të marrë vendimin e duhur, për ndërtimin e biznesit, për njohjen dhe përdorimin e produkteve të FLP. Shumë vetë pyetën kur do të zhvillohet përsëri ky aktivitet!

**János Tóth menaxher**





Erdha në këtë aktivitet me dy mikeshatë miat, për një kontroll mjekësor të përgjithshëm. fatkeqsisht nuk mund të futeshim kudo sepse kishte radhë të gjata të njerzve që prisnin. Koha ishte e bukur dhe nuk na u desh të prisnim shumëU kënaqëm edhe me leksionet, ishin intrsante. U ndjemë mirë, por ajo që vërtet ishte e mirë, edhe rezultate tona ishin të mira.

**Zsuzsa Varga - asistent supervisorore**


Si ish sportiste natyrisht zgjodha çadrën e angazhuar me problemet e sportit. Nga njerëz fantastikë dëgjovaleksione të mrekullueshme. Mendje, forcë, qëndrueshmëri- po të citoj István Halmi- ai që vulos rezultatin sportiv, ai mund të ndërtojë edhe rrjetin e FLP. Zsolt Fekete, me humor të jashtzakonshëm mbajti leksionin me titull „Ji në lëvizje” ku edhe me vogëlsira u bëri gjimnastikë dëgjuesve, ishte gjenial! Tamás Budai me dashurinë për sportin e bëri ta përjetonte edhe atë që nuk ishte marrë me sport. Aranka Vágási, e 3-ta në kampionatin botëror të hedhjes së shtizës , na tregoi se këtu kushdo mund të zerë vend, këtu nuk ka skualifikime.këtu janë lojra olimpike ku kushdo mund të fitojë medaljen e artë! Është është vendimi, dhe mund ta bësh edhe ti!

**Erzsébet Baranyai supervizore**



Pas hapjes të aktivitetit bashkë me burrin menduam që së pari të dëgjojmë leksionet e para tek çadra e sportit, pastaj të shikojmë më tej. Në fund mbetëm atje. Slogani që nga gjithkush mund të mësosh...po mundet. Shumicën e lektorëve i kishim dëgjuar shumë herë në shumë forume, por këtu, si i thonë, ndjemë nga afër atë energji, vendosmëri, këmbngulje, vetëdije për qëllimin që janë edhe baza e ndërtimit të biznesit.

**Amália Vászár Skáfárné menaxhere**



Në program u përfshimë gjatë leksionit të Istvan Halmi dhe menjëherë na mbërtheu mënyra e leksionit të tij, bota e mendimit të tij. Sipas nesh mësimi i thënjeve të tij, ishte ajo, që „nqse do të punosh në Forever”, atëhere angazhohu shpejt, bëne mirë, që të mund ti sigurosh vetes dhe të dashurve të tu një nivel jetese më të lartë se ajo që ke aktualisht. Fito më shumë para sepse mbi të gjitha duhen para, për shpenzimet e perditshme, për sport, për mësim, për kohë të lirë. Nga dr. István Taracközi mësuam gjëra me vlerë për kalitjen e kockave ndërsa dr Edit Révész Edit bëri diagnostikime të shputës të këmbës. Këtu mësuam se edhe unë si shumë të tjerë në zonën time kisha nevojë për plotësues me lëndë minerale. Në fund dëgjuam edhe koncertin e Ildikó Keresztes. Ishte një mbsadite shumë e vlefshme, dhe më vjen keq për ata që munguan!

**Ervin Bogdán dhe Katalin Szabó Bogdánné menaxherë**



# JAM MAKSIMALIST



## JÓZSEF MÁZÁS MENAXHER

**Menaxheri 35 vjeçar, drejton si teknik i industrisë të ndërtimit biznesin e tij që merret me zbatimin e pergjithshëm. Nga martesë e parë ka një vajzë, Timean , 9 vjeçe. Sponsor të tij janë József Szabó dhe dr.Renáta Szántó Szábóné. Me bashkëshorten Emilia Váradi jeton në Budapest.**

**Nuk keni shumë kohë që jeni lidhur me Foreverin dhe i jeni futur me energji të plota ndërtimit të këtij biznesi. Si shpjegohet kjo?**

Më e shumta kam 5 vjet që njihem me këto produkte. Me çështjen e biznesit atëhere nuk u mora. Në shkurt të këtij viti, u njoha me Miki Berkics, dhe atëhere fillova me ndërtimin e biznesit.

**Personi i Mikit ushtroi këtë ndikim tek ju ?**

Në një kuptim, po !

**A mund të na i permendni ata elementë, që nga përdorues produktesh të bëhesh ndërtues rrjeti?**

Nëpermjet biznesit tim personal, prej shumë vitesh, kisha lidhje biznesi edhe me mikun tim Józsi Szabó. Personalisht njihja një njeri të besuar, ai më thirri në një takim marketingu familjar. Aty u takova edhe me Mikin. Përfundimisht a idoli aty ku donte. Në atë takim të shkurtit pothuajse ishin vetëm sipërmarrës. Në fund aty qëndruam vetë 3 vetë. Isha kurioz, që me një bisedë personale, sa do të më marrë seriozisht. Pra, e mori seriozisht. Në fundjave pas takimit u ula para internetit, lexova gjithshka që munda të gjeja për firmën, dhe për Miklós Berkicsin. Të hën u takuam përsëri, dhe që nga ajo ditë vazhdojmë të punojmë së bashku.

**Cilat ishin hapat e para, si tu duk ndërtimi i biznesit?**

Kontaktlista őszeállítása, hanganyagok Përgatitja e listës të kontakteve me njerzit, dëgjimi i CD, bashkveprimi i ngushtë me sponsorin tim dhe me Mikin, pra me linjën e sipërme. Kam një listë timenn mjaft serioze, e shfrytëzova atë, planifikuam me saktësi çfarë dhe

si do ta bëjmë në dy javët e para, po kështu biseduam që në këtë periudhë do të merremi vetëm me marketingun tim. Motivimin e kisha që në qoftë se do të arrija 8 pikë, atëhere hotelin tim në Rally-in Europian të Vjenës do ta paguante sponsori im.

**E realizuat?**

Që në shkurt bëra 8 pikë. Për 8 javë arrita nivelin e menaxherit, ndërsa që nga prilli, çdo muaj kam plotësuar 60 pikë dhe që nga 1 qershori jam anëtar i Klubit të Conquistadorëve.

**Di për ju se sipërmarrja jote private lidhet me industrinë e ndërtimit it që sot në Hungari nuk është nga degët e sukseshme. Luajti rol edhe kjo që ti futeshe ndërtimit të rrjeteve?**

Fatmirësisht, sipërmarrja ime funksionon mirë, kam lidhje me kapitalin e madh dhe mendoj se jam njeri me emër në industrinë e ndërtimit. Tashmë kam 14 vjet që merrem me këtë, edhe tani kam punë sepse në këtë profesion kam emër të mirë. Kam një koleg biznesi të shkëlqyer, ai është gjysma tjetër e

imja, që më siguron atë lluks, që të mund të angazhohem me Foreverin, qoftë edhe 24 orë në ditë.

**Në çfarë ndryshon Foreveri krahasuar me bizneset tradicionale?**

Unë shikoj më shumë ngjashmëri, ai që ka emër në një biznes, ai emër do të ketë edhe këtu, njësoj, se kudo që të shkoj emri im një markë do të ketë. Nqse unë them se është fjala për një biznes serioz, se kam një shokë serioz biznesi, atëhere portat hapen.

**Si e shikoni të ardhmen tuaj në Forever ?**

Dua të bëhem diamant, ky është objektivi im. Se do ta arrij, këtë akoma nuk e di, as atë nuk e parashikoja që do të bëhesha shpejt menaxher. Bëra atë që më këshilluan sponsori im dhe Miki Berkics dhe u arrit. Punojmë në grup: Miki Berkics, József Szabó dhe dr. Renáta Szántó Szabóné, të cilët i falnderoj për kohën dhe energjinë me të cilën kanë ndihmuar punën time. Për produktet nuk kam akoma njohuritë e duhura, por për këtë më ka ndihmuar shumë Renáta, e cila është profesioniste dhe vjen kudo ku e kërkoj. Nuk ka javë

që të mos bisedojmë, që të mos punojmë së bashku. Dhe kjo punë , mbasi unë kam arritur shkallën e parë të menaxherit.

**Personaliteti yt çfarë i ka sjellë kësaj skuadre?**

Maksimalizmin. Ai që punon me mua, e di që unë diçka që vendos, atë e kryej dhe e çoj deri në fund. Situata e bashkpunëtorëve të mi është shumë e lehtë, as ata nuk kërkojnë prej meje të pamundurën. Kur në orën 10 të mbrëmjes duhet bërë një takim marketingu, kur në fund jave duhet udhëtuar për në Erdely apo për në Serbi, unë jam gati.

**Sa ka ndryshuar jeta jote që nga shkurti?**

Qind për qind. Arritja e nivelit të menaxherit është shumë e vështirë për këdo, ashtu ishte edhe për mua. Në periudhën e parë punoja 14-16 orë, shumë më tepër se përpara, por ia vlejti. Në 14 vjetët e bëra në industrinë e ndërtimit nuk kisha arritur të ndërtoja një skuadër të tillë, që të mund ta bëja vetëlëvizës biznesin tim. Objektivi im këtu është ai që të ndërtoj një rrjet të tillë që jetë në gjendje të eci edhe pa mua.



NË DITËT E SOTME PEDIKYRI ESTETIK DHE KURUES ËSHTË BËRË GJITHNJË E MË POPULLOR DHE GJITHNJË E MË SHUMË RRITET NUMRI I MYSAFIRËVE QË LARGOHEN NGA SALLONI ME NDJENJË KOMODITETI, PËR TU KTHYER PRAPË HERË TJETËR. POR N.Q.S. E KEMI KOHËN TË KUFIZUAR, KËTË NDJENJË MUND T'A ARRIJMË EDHE NË SHTËPI!

# Sallon pedikyri kurues NË SHTËPI



**G**jendja e shputave të këmbëve, e thonjve të këmbëve mund të varet nga shumë gjëra: nga këpucët që përdorim, nga lloji i lëkurës, nga higjena dhe nga shputa e këmbës, nga rëndesa e kockës apo edhe nga pesha e tepërt. N.q.s. ndjejmë dhimbje tek thonjtë ose në pjesë të ndryshme të shputës së këmbës, duhet të konsultohemi me specialistin, të mos i prekim në shtëpi, sepse në përgjithësi të çojnë drejt inflamacionit apo dhimbjeve më të mëdha, në rastet më të rënda mund të jetë e nevojshme edhe ndërhyrja mjeksore. Me pranimin e disa këshillave mund të shmangim krijimin e këtyre problemeve. Të gjithëve e kam zakon t'ju rekomandoj, që një-dy herë në javë t'ju bëjnë banjë këmbëve, pamvarësisht nga stina. Është gjë shumë e mirë edhe atëhere, n.q.s. dikush dëshiron të relaksohet pas një dite të vështirë, të lodhshme dhe të stresuar. Relaxation Bath Salts me livando dhe limon vë në lëvizje qarkullimin e gjakut, përmbajtja e aloes dezinfekton lëkurën dhe gjëndrat dhjamore, dhe nëpërmjet kësaj edhe lëkura problematike që djersit mund të freskohet. Do të rekomandoja, që pas një banje prej njëzet-tridjet minutash të fshijmë vetëm pjesën midis gishtave duke larguar mbetjet e ujit, ndërsa në pjesën tjetër të shputës e lëmë të thahet në të – kështu arrijmë edhe efektin e dezodorit. Në rast se ka nevojë për pastrim dhe trajtim të mëtejshëm, mund të hedhim në ujë edhe sapun të lëngshëm aloe, e cila na jep një ndihmë shumë të madhe në zbutjen e lëkurës. Nuk do të rekomandoja në asnjë mënyrë në trajtimin shtëpiak, përdorimin e brisqeve të mprehta, thikave për kruajtjen e thëmbrave, zdruktheve të lëkurës, pa dezinfektim! Në lëkurën e zbutur, ato mund të shkaktojnë shumë lehtë plagë, mbas së cilës ecja bëhet e dhimbshme. Për shkurtimin e thonjve të përdorim prerëse cilësore, por edhe këtë duhet ta bëjmë vetëm pas zbutjes së tyre. Largimin e papastërtive poshtë lëkurës dhe anëve të thonjve të këmbës e përfundojmë me një largues lëkure jo të mprehtë ose me shkop. Për shputën e këmbës është ndjenjë e mirë, n.q.s. do ti bëjmë masazh me Aloe Scrub, pastaj mbas largimit



të qelizave të vdekura i hidratojmë me Relaxation Massage Lotion, dhe i dezinfektojmë me Aloe Gelly që ka pastërti uji dhe përthahet shpejt. Këtë mund ta përdorim edhe tek këmbët ose midis gishtave të këmbëve që djersisin shumë. Kur ka inflamacion të anëve të thonjëve apo të sipërfaqes së lëkurës, zakonisht këshilloj, trajtimin me Aloe Propolis Creme dhe Aloe First që kanë efekt në uljen e inflamacionit dhe shërimin e plagëve. Larjen e përditshme, pastrimin si dhe trajtimin e lëkurës duhet ta përfundojmë me atë, që shputat e këmbëve dhe duart ti lyejm me çdo lloj hidratuesi me vitamina (Aloe Lotion, Aloe Moisturizing Lotion).

Tek blerja e këpucëve duhet të kemi kujdes që të zgjedhim masën, ajrimin, takën dhe formën e duhur. Zonjat, n.q.s. do ti përdornin vetëm me raste, pra jo çdo ditë, takat e larta, ato nuk do ti dëmtonin shumë kyçet, indet e këmbëve, prandaj duhet anashkaluar përdorimi i përditshëm. Por edhe n.q.s. do të jetë i pashmangshëm përdorimi i shpeshtë i tyre, atëherë të zgjedhim këpucë shumë cilësore, ose ti ndihmojmë këmbët duke përdorur shtresa që shërbejnë për ngritjen e shputës. Këpucët që janë shumë të ngushta shkaktojnë fryrje, trashje të lëkurës, dhe krijojnë shpejt kallo.

Enjtjen e këmbëve që vjen në fund të një dite pune ulur ose qëndrimi në këmbë mund ta shërojmë duke i ngritur ato lart dhe duke konsumuar Aloe Blossom Herbal me efekt shkarkues .

Për probleme më speciale dhe për largimin e dhimbjeve apo edhe

**Krisztina Hasznosi**  
**Specialiste kozmetike**





TERÉZIA HERMAN SOARING MENAXHERE

# JAM NË VENDIN E DUHUR

**Thonë se bashkëshorti juaj jo vetëm që më përpara ishte ndërtues rrjeti, por edhe shumë i suksesshëm, por sot punon në tregëtinë tradicionale. Pse nuk u lidh me ju?**

Është hedhur disa herë mendimi, por një herë për një herë nuk ka një vendim të tillë. Nqse do ta ndjejë, se ku dhe si mund të pershtatet më mirë në biznes.

**Tashmë të është bërë e zakonshme që rezultatet i arrin vetëm.**

Po, dhe nuk ka qënë gjithmonë e lehtë. Për shumë kohë rrita e vetmuar vajzën, dhe shpesh më shkonte ndërmend që mirë do të ishte një çift, që nuk të mbështet vetëm në prapavijë, por me mua bashkë të mbajë edhe flamurin. Në fillim dukej keq kur shikoje që të tjerët veprojnë sëbashku, por pastaj gjeta atë skuadër, që mundën të më mbështesnin.

**Si grua shumë duhet të sigurohesh?**

Në një kuptim, po, megjithse këtë disfavor të dyfishtë mund ta kthesh edhe në avantazh. Nuk e lehtëson punën, që shumë burra, tek unë shikojnë gruan, si shok biznesi të mundshëm dhe sigurisht ishte e vështirë ta kaloje, që të ruash mardhënie të mira, por tashmë jam në gjëndje ti përcaktoj kufijtë. Që nga ajo kohë u njoha me bashkshortin tim dhe qe një gjë e rëndësishme, që edhe atëhere ta ndjejnë prezencën e tij, edhe nqse nuk është me mua, si shoqet e mia të biznesit ashtu edhe bashkëshortët e tyre. Dhe nga ana tjetër pranoj legjitimitetin që ky biznes nuk funksionon me zorrë nëper këmbë, gjëra të tilla mund ta shkatërrojnë këtë biznes.

**Ç'loj njerzish mbledh më me qejf rreth vetes?**

Njerëz të tillë që kanë etikë me veten e tyre, me bashkëshortin e tyre, por edhe me grupin. Njerëz me gërma të mëdha, që nqse në diçka ti fute 50 përqind, 50

përqind të tjerat ti futë ai. Vetëm kështu mund të bëhemi të suksesshëm të dy. Ti je një rubinetë e vogël uji, por kur bëhen shumë rubineta bashkë krijohet një vërshim i madh që ka forcë. Për mua këtij i thonë biznes. Një Niagara.

**I mban mend fillimet?**

O, shumë! Për 3 muaj arritëm nivelin e menaxherit, pastaj ndodhi një çarje serioze në jetën time: u ndava dhe pastaj e re humba të dy prindërit e mij. Ishte e vështirë të vazhdoje vetëm, me vështirësi e me përplasje rinisi gjithshka. Por ishte e habitshme, që ndërkohë që unë isha angazhuar me problemet e mija, si të rikuperoja humbjet, grupi im me drejtuesit eci përpara më tej

**Çfarë qëllimi të ri i vure vetes?**

Të ruaja ekuilibrin. Të rrisja biznesin tim, por ndërkohë të mbetesha nënë, mbasi një fëmi të vetëm kam, dhe bashkë e planifikuam gjithshka, që edhe ajo të ketë objektivat e saja, që ta kuptojë pse dal nga shtëpia. Ishte e vështirë që të ishe njëkohsisht nënë, drejtuese biznesi dhe zonjë shtëpie dhe krahas kësaj të krijoje mardhënie të reja bashkëshortore. Sa kisha prindërit gjallë e kisha më të lehtë, sepse më mbështesnin në gjithshka. Vajza Detti jetonte me ta në fshatin e lindjes pranë Salgótarján, kurse unë në Budapest që të mund të punoja. Shumë herë më tërhiqte për fustani „mami mos ik”, kështu e kisha shumë të vështirë ulesha në sedilen e makinës.

**Cili është profesioni juaj bazë?**

Kujdestare çerdhje dhe kopshti, por kur u mbyll çerdhja ku punoja, kalova në shtëpinë e të moshuarve dhe si infermiere në urgjencën e aksidenteve. E pëlqeja punën që kisha por ishte shumë e lodhshme: shumë punë dhe pagesë e ulët.

**NDËRMJET DREJTUESVE  
KRYESOR NË FOREVER TË  
PAKTA JANË GRATË, AQ MË  
PAK, QË SI GRA E ZHVILLOJNË  
VETËM BIZNESIN. SIGURISHT  
NË PRAPAVIJË EDHE TERÉZIA  
HERMAN E NDIHMOM DIKUSH.  
NË 5 MË TË MËDHENJTË E  
HUNGARISË KA ARRITUR ME  
FORCAT E VETA.**





### **Nqse do ti krahasoje, fitimin e tanishëm me të atëhershmin dhe sa punon, më shumë apo më pak?**

Me gjithë kompensimet familjare fitoja tetëmbëdhjetë mijë forinta. Këtë biznes e fillova se vajza më kërkonte një kile banane kurse unë mund ti bleja vetëm një copë.

### **Po sot mund tia blesh një kile?**

Mund ti marr edhe disa kuintalë, por pamvarsisht nga paratë një ndjenjë të jashtzakonshme të jep fakti që aktualisht unë jam pesëshen më të sukseshme hungareze. Kjo është një kategori komplet tjetër, pa folur për atë që punoj bashkë me një nga grupet më të forta të Hungarisë, me drejtues të tillë që përfaqsojnë vlera të jashtzakonshme.

### **Ndërsa për vlerat në shifra sikur nuk ke qejf të flasësh.**

Jo, në gjëra të tilla jam e hapur, shumë thonë se jam tepër modeste. Fakti është që në saje të FLP mora shtëpinë. Eshte e vertetë, që kur mora veturën e paguar nga firma dhe e çova në shtëpi, nëna më pyeti, je e sigurtë që nuk do të shkosh në burg. Një ngjitje e tillë asaj i dukej e pabesueshme!

### **Po përsa i perket orëve të punës?**

Si infermiere kishte raste që ishim „gjashtëmbëdhjet orëshë” sepse duhej zëvendësuar dikë. Si forever në fillim ka ndodhur që dilja nga shtëpia në mëngjes në orën dhjetë, dhe kur ecte puna në shtëpi kthehesha në orën gjashtë të mëngjezit tjetër kur duhej të çoja vajzën në shkollë. Tani nuk punoj as çerekun e asaj, edhe sikur të mos lëviz dorën, ky grup edhe atëhere mund të eci. Por

më pëlqen të punoj. Tash e bëj për atë, sepse sikurse thotë Rex Maughan, kjo është një mënyrë jetese. Kam nevojë për komunikim me njerzit, të bisedoj me ta, tu jap këshilla.

### **Kur luftoje vetëm, të lindi ndonjë herë mendimi që të hiqje dorë?**

Kurrë. Këtu gjeta veten dhe atë firmë që është korekte me mua. Kur për herë të parë ishim në Amerikë, mora një forcë të jashtzakonshme. Kur rex kapi valixhen time dhe e hypi në autobus, apo kur Gregg rregulloi vizën e vajzës time që të vinte dhe të kthehej me ne, ky kujdes më la mbresa të vecanta. Atëhere Greggu më përqafoi dhe vetëm kaq tha: „mos u habit, ne kurrë dhe askënd nuk e braktisim”. Atëhere u gëlltita dhe mendova: jam në vëndin e përshtatshëm.

### **Kualifikimi yt në fushën e shëndetit të ka ndihmuar edhe në këtë punë?**

Di se si funksionon organizmi dhe kaq. Nuk varet nga kjo. Bashkpunëtorët e mij nuk i kam nga profesioni im i mëparshëm, por më tepër kam gjetur drejtues të mirë. Një pjesë e tyre ishin sipërmarrës të gjallë, gjë që më ndihmoi se nuk kish nevojë tu mësoje atyre menaxhimin.

### **Po ti vetë? E ke talent të lindur?**

SNuk bëhet fjalë për këtë. Më përpara kam qënë njeri pa fjalë, e mbyllur në vetvete, njeri i frenuar. Siklet e kisha edhe të flisja para njerzve. Në shkollë mund të më binte të fikët, nqse më kërkonin të pergjigjesha. Por sa më shumë praktikohesha aq më mirë ecte komunikimi me njerzit, dhe tani nuk e

kam problem, që të dal para të tjerëve, tu tregoj se si e bëj biznesin. Kam mësuar se nqse kujdesem për dikë, ky kujdes më rikthehet, sepse jeta synon ekuilibrin.

### **Në këtë sukses ka pjesë edhe cilësia e produkteve?**

Mund të shitesh edhe tjetër, por kur je 44 vjeçe, nuk mund të dukesh më e re se sa je (*qesh*). Produktet më pëlqejnë shumë, marr tableta, pi lëngje, lyhem me to, provoj gjithshka, dhe është një ndjenjë e mirë kur në sauna, pyesin vajzën Detti, se kur do kthehet prapë infermierja...

### **Pra me një fjalë me vajzë shkoni bashkë në sauna. Keni mardhënie „si mikeshat”?**

Po, kemi mardhënie besimi të plotë. Isha 24 vjeçe kur e kam lindur, dhe kur mbetëm vetëm, vetëm njëra tjetrën kishim. Edhe unë nuk kam jetuar periudhën klasike të adoleshencës, nuk kishim diskutime, nuk grindeshim, por ndoshta falë edhe këtij biznesi: kam mësuar se duhen trajtuar kundërshtitë dhe të komunikojmë për të ecur në atë drejtim që do të dëshiroja, ndërkohë pa e shtypur tjetrin. Një herë e pyeta vajzën, sa ka duruar që shumë herë, për shkak të punës më duhej ta lija në shtëpi me prindërit e mi. Më tha, se nuk do ta ndërronte jetën e tanishme me të atyre me të cilat atëhere qëndronin në shtëpi, por sot duhet luftuar me problemet e përditshme.

### **A do të jetë edhe ajo pjesë e FLP?**

Eshtë detyrë e vështirë të jesh fëmija i një prindi të sukseshëm, mbasi përpara këtij fëmije ka një model, por nuk është



i sigurtë se do ta ketë të lehtë ta kopjojë. Detti është në vitin e pestë të mjekësisë, po kush e di. I intereson biznesi, është kurioze për të, plus kësaj nga puna ime ka jetuar kaq gjatë me të sa që edhe mund ta bëjë. herë herë na ngatërrohen zerrat në telefon , dhe ka ndodhur që ajo ka dhënë këshilla biznesin në emrin tim.

#### **Sándorin, bashkëshortin tënd ku e ke njohur ?**

Në fakt edhe për atë duhet të falnderoj Foreverin. Përmes tij doja ti dërgoja produktet një bashkëpunëtori, por kur erdhi për ato, thjesht mu ngjit, dhe vetëm atëhere e vumë re kur llafoseshim nga ora pesë e mbasdites deri në mesnatë. Deri ditën e sotme

kështu vazhdon, ka probleme të biznesit dhe sfida të jetës të cilat nuk mund ti diskutoj me askënd përveçse me atë. Për mua është edhe një stakim nga puna e përditshme kur shetisim dorë për dorë, dhe qind përqind i perkushtohemi njeri tjetrit.

#### **Vjet dhe sivjet jeni ndërmjet 5 distributorëve më të medhenj të Hungarisë, dhe ke lidhje biznesi në më tepër se 20 vende. Në çfarë drejtimi mund të zhvilloheni më tej?**

Në radhë të parë me personalitetin tim. Vazhdimisht jam e pakënaqur m eveten, dëshiroj zhvillim të vazhdueshëm. E di se ku jam, por dhe niveli i të tjerëve, ku do të doja të arrija, por kjo nuk

është gjithshka. Do të doja që njerzit të më kuptojnë më mirë, se për çfarë dhe pse e bëj këtë. Por jam e duruar, pres momentin e përshtatshëm, deri sa dikush të mund të jetë bashkpunëtori im , dhe nuk e largoj nga vëmendja. Deri sa të vijë situata që vetë ai i do produktet, biznesin apo sipërmarrjen, apo edhe të dyja dhe produktet dhe biznesin. Unë u vë përpara një tabaka të madhe, ku secili merr atë që do, atë që i mungon më shumë. Nga 100 vetë vetëm 20, do të jenë ata që kanë nevojë, por edhe 80 të tjerët nuk duhen harruar. Nuk sillem keq, edhe ky është një mësim. Ndërsa i dua tamam si vetë punën. Për të mos thënë edhe më shumë...



# Success Day

BEOGRAD 18.06.2011

**D**rejtuesit e trajnimit të mëtejshëm të qershorit ishin soaring manager-ët **Milena dhe Milenko Petrovic**. Me një entuziazëm të madhë, energji pozitive dhe vizion të qartë drejtuan këtë program të pasur. Të ftuarit e mbledhur në ambjentin e Qendrës Sindikale, i përshëndeti drejtori rajonal i Serbisë **Branislav Rajic**. – Gjithmonë jemi një hap më përpara se të tjerët, falë cilësisë së produkteve, planit të shkëlqyer të marketingut, besnikërisë së distributorëve, të rejave në vazhdimësi, të cilat sigurojnë një punë më të lehtë, më të efektshme dhe më të mirë. Ju urojmë një verë të mirë me FLP-n! – filloi programin.



**NË DITËT E PARA TË VERËS U MBLODHËM PËRSËRI NË  
TRAJNIMIN E MËTEJSHËM TË BASHKPUNTORËVE TANË MË  
TË SUKSESSHËM NË FOREVER LIVING PRODUCTS.**

Në jetën e çdo njeriu duhet që të luaj rol qëndror mënyra e të ushqyerit dhe përdorimi i plotësuesve ushqimorë-pamvarsisht nga mosha. Është e rëndësishme që të merremi me të ushqyerin dhe mënyrën e shëndetshme të jetesës që në periudhën e krijimit të fëmijës, më pas ta mbajmë nën mbikqyrje gjatë kohës së shtatzanisë, fëmijëris dhe adoleshencës. **Dr. Dusanka Tumbas** senior manager e vërtetoi këtë slogan me shembullin e vet.

Gjithnjë e më shumë njerëz merren në kohën e lirë me sporte ose aktivitete të tilla, në përshtatje me moshën, gjëndjen fizike dhe qëllimin. Duhet të dijmë të bëjmë përdorues të produkteve të FLP-s pasuesit me orientim wellnes-fitness, sepse produktet tona janë të shkëlqyera për vazhdimin e një jete aktive. Manager-ët **Sinisa Blaskovic** dhe **Branislav Rajic** në leksionin e tyre na njohën, se si ndihmojnë produktet e FLP-s tek rinia, sportistët amatorë dhe profesionist.

Mësojmë nga eksperiencat, këto instruktajnë pjesën më të rëndësishme të jetës sonë. Në Ditën e Suksessit një nga pjesët më kuptimplote është ajo që ka të bëjë me përdoruesit dhe eksperiencat e mjekëve. Përdoruesit e produkteve dhe përshkrimi i sinqertë i mjekëve, të cilët i njohin produktet nga praktika e përditshme, me drejtimin e **Dr. Rozmaring Mirkov** thanë, që ata janë plotësuesit e rëndësishëm për një jetë të shëndetshme.





Në skenë patëm mundësi të përshëndesnim supervizorët e rinjë. Ky klasifikim llogaritet si një hap paraprak i konsiderueshëm drejt krijimit të një biznesi të pavarur. Shpresojmë, që të klasifikuarit e rinjë edhe në muajt e ardhshëm të arrijnë suksese dhe të realizojnë qëllimet e përcaktuara.

Argëtimi është pjesë përbërëse e takimeve tona, por vetëm më të mirët janë në gjendje që me performancat e tyre artistike të ngrenë në këmbë publikun. I preferuari i pjesës së publikut me antare femra **Milan Topalovic Topalko** vërtetoi përsëri, që është mik i madh i FLP-s.

Ditë për ditë duhet ti bëjmë vetes pyetjen: Çfarë bëra sot për interesat e mija? Kështu të përcaktojmë qëllimet tona dhe të shmangim pengesat që ngrihen para nesh. Manager-i **Slobodan Antonijevic** më përpara ishte i papunë, pastaj në punë shteti, më pas u punësua në një firmë private, së fundi u bë sipërmarrës në Forever. Slobodani e arriti pavarësin materiale nëpërmjet mentalitetit të sipërmarrjes së lirë, gjeti mundësi për ndarjen e kohës së lirë dhe për njohjen e një numri të madh njerëzish si dhe për të ndihmuar të tjerët.



Duke e krahasuar me periudhën e një viti më parë bashkpuntorët që arritën xhiron më të madhe hynë në Klubin e Sundimtarëve. Dëgjuam deklaratat e falenderimit të më të suksesshëmëve, ju urojmë atyre, të shndrohohen në bashkpuntorët më të suksesshëm!

Këtë vit parrulla e FLP-s në të gjithë botën ishte: „no limits”. Të gjithë ato, që jetonin diku në ëndrrat tona, tani nëpërmjet Forever-it mund të bëhen të realizueshme. Firma jonë jep recetën për realizimin e ëndrrave, ndërsa kjo kërkon një punë këmbëngulëse dhe të vendosur. Nëpërmjet Forever-it prej secilit mund të bëhet “dikushi”, n.q.s. do të ndjeki parimet prej tre dhjetvjeçarësh të biznesit të dhëna nga Rex – tha një nga bashkpuntorët tanë më të suksesshëm, **Dragana Janovic** soaring manager.







FLP-ja ju ofron bashkpuntorëve krahas bonuseve mujore edhe programe promovuese. Njëri prej tyre është programi i quajtur Holiday Rally që mbahet në Poreç. Periudha e parë e kualifikimit u mbyll në 30 prill, e dyta është në vazhdim, jepini forca! Mundëm të përshëndesnim në skenë të kualifikuarit për periudhën e parë të programit promovues, ndërsa të tjerëve të cilët vazhdojnë të punojnë për kualifikim, ju urojmë shumë sukses.

Rally i Europës është parakalimi i trupave më të suksesshëm, por dhe i më të mëdhenjve! Në 2012 Budapesti do të presi mysafirë më të mirët e Europës, merrni pjesë atje edhe ju! Përparësit e programeve promovuese, mënyrat, se si mund të realizohen sfidat, i treguan me hollësi **Milos Janovic** soaring manager dhe **Stevan Lomjanski**, duke i shoqëruar me foto të shumta.

Para se të shpërndanim distiktivët e assistant supervisorëve të rinjë, njoftuam takimin e rradhës, i cili do të mbahet në 24 shtator në ambientet e Qendrës Sindikale.

**Branislav Rajić**  
